



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË

Nr. 7550/1 Prot.

Bulqizë, më 12/12/2022

Lënda: Kthim Përgjigje.

Drejtuar: Qendra "Res Publica"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 24 , H.3, Ap. 7 , Tiranë.

Në përgjigje të shkesës tuaj me nr 194/22 e protokolluar pranë Bashkisë Bulqizë me nr 7550 prot. datë 05.12.2022 , ku kërkohet informacion në lidhje me VKM- në nr. 59 datë 26.01.2022 " Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtarë (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore" dhe në bazë të Ligjit 119 /2014 "Për të drejtën e informimit " neni 3 i këtij ligji iu informojmë si më poshtë :

Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka zhvilluar dëgjese publike me Bashkinë Bulqizë dhe bashkitë e tjera që kanë në pronësi sipërfaqe të zonave të mbrojtura në territorin administrativ të tyre por që administrohen nga ana e tyre. Kjo dëgjese është zhvilluar në Elbasan dhe para se të miratohet VKM- ja Nr. 59 datë 26.01.2022.

Bashkia Bulqizë ka shprehur dakordësinë për këtë sepse ndarja dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura me status të veçant të bëhet nga një strukturë e posaçme e cila do ti ketë në menaxhim.

Kjo nuk e cënon territorin administrativ të Bashkisë Bulqizë por thjeshtë menaxhimi i këtyre sipërfaqeve me status të veçant bëhet nga një strukturë tjetër me vartësi qendrore dhe jo lokale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Leonard DACT

